

SHOQERIA "FLAMURTARI FOOTBALL CLUB" SH A
NIPT L171302031
SELIA - LAGJA "PAVARSIA", STADIUMI "FLAMURTARI"
VLORE

VLORE, ME 02.08.2014

Nr Prot.

VENDIM NR 1

I KESHILLIT MBIKQYRES TE SHOQERIA "FLAMURTARI FOOTBALL CLUB" SH A

Sot ne Vlore , ne ditën e dytë te muajt Gusht te vitit dymijë e katermbëdhjetë , ne Selinë e shoqerisë "FLAMURTARI FOOTBALL CLUB" SH A ne Lagjen "Pavarsia" , prane Stadiumit "Flamurtari" u mbledh Keshilli Mbikqyres, me pjesëmarrjen e :

- ILIR BANUSHIT.
- ANILA CUKANI
- ILIR META

Ne baze te Nenit 29 te Statutit te Shoqerise "FLAMURTARI FOOTBALL CLUB" SH A lidhur me emerimin dhe shkarkimin e Administratorit vendosem sa vijon :

- Te largohet nga detyra e Perfaqesuesit Ligjor i shoqerise Z . Geri Cipi .
- Te emerohet si Perfaqesues Ligjor i Shoqerise Z . Ardi Behari , me karte Identiteti Nr , Lindur e banus ne Vlore prej 03.08.2014 deri me 02.08.2016 .

1

Sa me siper nenskruhet prej te pranishmit pa verejtje

KESHILLI MBIKQYRES I SHOQERISE "FLAMURTARI FOOTBALL CLUB" SH A

ANTAR

(ANILA CUKANI)

ANTAR

(ILIR META)

KRYETAR

(ILIR BANUSHI)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KESHILLI I BASHKISË VLORE

V E N D I M

Nr. 39, datë 31/07/2014

**“PER DISA NDRYSHIME NE ADMINISTRIMIN E SHOQERISE FLAMURTARI
FOOTBALL CLUB SHA”**

Në bazë të nenit 1/I/a,c, 1/II/a,b,c, 1/VI/a,b,d, neni 10/1,3, 8/II dhe 32/e të Ligjit Nr. 8652 datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, në ligjin Nr.9376, datë 21.4.2005 “Për sportin” neni 8/2, neni neni 19/1,3, neni 24, neni 30, neni 32, ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” neni 135, neni 167, Statutit dhe Aktit të Themelimit të shoqërisë “Flamurtari Football Club”, Rregullorja dhe Statuti i Federates Shqiptare të Futbollit, Këshilli i Bashkisë Vlorë,

VENDOSI

1. Te miratohet kontrata e financimit dhe administrimit të shoqërisë FLAMURTARI FOOTBALL CLUB SHA dhe “TRK Group” e “Atlasjet” të perfaqësuar nga z. Sinan Idrizi, sipas plan financimit të paraqitur (draft kontrata bashkelidhur projekt vendimit).
2. Te miratojë ndryshimin e pikave 21 dhe 23 të Statutit Themeltar të shoqërisë FLAMURTARI FOOTBALL CLUB SHA.

Neni 21 i statutit ndryshohet si me poshte:

Paragrafi i dyte:

Anetaret e Keshillit Mbikqyres do te jene 4 (kater) ne numer, si me poshte vijon:

- a. SINAN IDRIZI
- b. ROBERT ISLAMAJ
- c. KRESHNIK ÇIPI
- d. SAIMIR HAXHIU


Kohezgjatja afatit të mandatit të anetareve të Keshillit Mbikqyres do të jete dy vjet. Ata kanë të drejtë të rizgjidhen.

Neni 23 i statutit ndryshohet si me poshte:

Paragrafi i dyte:

Anetaret e Keshillit Mbikqyres nuk mund të shkarkohen nga detyra pa mbaruar afati i emerimit të tyre. Ata mund të shkarkohen vetëm kur konstatohen shkelje në detyrë, vepra penale, apo veprime që janë në kundërshtim me interesat e shoqërisë “Flamurtari Football Club” sha.

3. Miratimi i këtij vendimi nuk e pengon vazhdimin/perfundimin e procedurave të privatizimit të shoqërisë FLAMURTARI FOOTBALL CLUB SHA të miratuara nga Keshilli i Bashkisë Vlore.
4. Te ngarkohet Kryetari i Bashkisë Vlore për nënshkrimin e kontratës përpara noterit dhe zbatimin e këtij vendimi.


Evis ALLUSHI
KRYETAR





**"FLAMURTARI" FOOTBALL CLUB
VLORE**

Adresa: Lagjja "Pavaresia", Bulevardi "Ismail Qemali", Vlore, Tel,Fax: 033 421 242,info@flamurtarifc.com

Nr 117 prot

Vlore 29 . 10 .2014

Lenda: Njoftim per rregjistrim

Drejtuar : Q.K.R Vlore

Bordi drejtues i Flamurtari Football Club ne mbledhjen e tij te pare ne diten e sotme e merkure ,me date 29.10.2014 ne pranine e te gjithë anetareve te bordit z.Sinan Idrizi, z. Robert Islamaj , z. Kreshnik Cipi dhe z. Saimir Haxhiu vendosi :

1.Zgjedhjen e z. Sinan Idrizi si kryetar te bordit drejtues te Flamurtari FC.

2.Ngarkon administratorin e Flamurtari FC z.Ardi Behari per te bere ndryshimet e nevojshme prane Q.K.R Vlore

Anetaret :

1.Sinan Idrizi

2.Robert Islamaj

3.Kreshnik Cipi

4.Saimir Haxhiu





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KESHILLI I BASHKËS VLORË

Adresa: Sheshi "4 Heronjtë", Tel: 033 421202; Fax 033 421205 E-mail: info@vlora.gov.al
Nr. 38 prot

Vlorë më 28/07/2016

VENDIM

Nr. 38, datë 28/07/2016

"PER SHTYRJE E AFATIT TË KONTRATËS PËR ADMINISTRIMIN DHE FINANCIMIN E SHOQERISE FLAMURTARI FOOTBALL CLUB SHA"

Në bazë të nenit 8/2, 9/1.2, 25/4, 54 të ligjit Nr.139/2015 date 17.12.2015 "Për veteqeverisjen vendore", ne ligjin Nr.9376, datë 21.4.2005 "Për sportin" neni 8/2, neni 19/1,3, neni 24, neni 30, neni 32, ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" neni 135, neni 167, Statutit dhe Aktit të Themelimit të shoqërisë "Flamurtari Football Club", Rregullojta dhe Statuti i Federates Shqiptare të Futbollit, VKB nr. 39 datë 31.07.2014 "Për disa ndryshime në administrimin e shoqërisë Flamurtari Football Club sh.a", Marrëveshjes së financimit dhe administrimit të shoqërisë "Flamurtari Football Club" të lidhur midis Bashkisë Vlorë dhe shoqërive "TRK+ATLASJET", Këshilli i Bashkisë Vlorë,

VENDOSI

1. Te miratohet shtyrja për një periudhe 2 vjecare të kontratës së financimit dhe administrimit të shoqërisë "Flamurtari Football Club" të lidhur midis Bashkisë Vlorë dhe shoqërive "TRK+ATLASJET" sipas kërkeses të paraqitur bashkelidhur projekt vendimit.
2. Të miratohen Anetaret e Keshillit Mbiqyres, te cilet do te jene 4 (kater) ne numer, si me poshte vijon:
a) Sinan Idrizi
b) Kreshnik Çipi
c) Robert Islamaj
d) Teki Xhemalaj

Kohezgjatja e afatit te mandatit te anetareve te keshillit mbiqyres do te jete 2 vjet. Ata kane te drejte te rizgjidhen

3. Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes se ligjshmerise nga Prefekti i Qarkut.

KRYETARI



LENDA: KERKESE PER DOREHEQJE

DREJTUAR :Z.SINAN IDRIZI

KRYETAR I KESHILLIT MBIQYRES FLAMURTARI FOOTBALL SH.A

I NDERUAR Z.IDRIZI

Si anetar i Bordit Mbiqyres i Flamurtari Football Sha prej afro 1viti emeruar prej Keshillit te Bashkise Vlore duke qene shume prane gjithe diskutimeve ne lidhje me ecurine e skuadres se futbollit Flamurtari pas problematikave te marrjes se pergjegjesise institucionale por dhe morale ,ndjere i pafuqishem ne rolin tim per te kontribuar ne zgjidhjen e kesaj suate te veshitre paraqes perpara jush si Kryetar i Bordit doreheqjen time nga ky bord Mbiqyres duke vleresuar maksimalisht bashkepunimin tone kete periudhe ne modernizimin e mbarevajtjes se ketij institucioni ,vizionin tuaj per nje Flamurtar Elite.

Kjo doreheqje le te sherbeje per tu vene ne levizje te gjitha institucionet per te mos e lene emblemen e qytetit ne renie te lire ,qe Flamurtari i madh te shkoje atje ku i takon te jete .

Kontributi im personal ne respekt te marredhenies ,sone jo vetem institucionale por edhe qytetare nuk do te kursehete sa here do te kerkohet.

Me konsiderate

SAIMIR HAXHIU



"FLAMURTARI" FOOTBALL CLUB
VLORE

Adresa: Lagjia "Pavaresia", Stadiumi Flamurtari, Vlore, Tel./Fax: 033 421242, fclflamurtarivlore@gmail.com

VENDIM

Datë 07.08.2016

Bazuar në Vendimin Nr.38, datë 28.07.2016, të Këshillit të Bashkisë Vlorë, "PER SHTYRJE E AFATIT TË KONTRATËS PËR ADMINISTRIMIN DHE FINANCIMIN E SHOQERISE FLAMURTARI FOOTBALL CLUB SHA.", Statutit të Flamurtari Football Club Sh.A., Këshilli Mbiqyres i Flamurtari FC,

VENDOSI:

1. Të riemërojnë si administrator të shoqërisë Flamurtari Football Club, Z. Ardi Behari.
2. Administratori do të vazhdojë të kryejë funksionet për administrimin e përditshëm të Klubit sipas udhëzimeve të Këshillit Mbiqyres.
3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

PËR KËSHILLIN MBIQYRËS

SINAN IDRIZI
FLAMURTARI FC



10.08.2016
ORIGINALI MËRROHET NË
A KIVENË BASHKISË VLORE
DALE NE DATEN 16/08/2016

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT VLORE
SEKTORI JURIDIK

Vlorë, më 09.08.2016

Nr. 2302 Prot

Lënda: Shprehje për ligjshmerinë e vendimeve të Këshillit të Bashkisë Vlorë.

Drejtuar: Z.Dritan Leli,

KRYETAR

Për dijëni: Këshillit të Bashkisë

VLORE

Në mbështetje dhe zbatim të nenve 6 dhe 14 të Ligjit nr. 8927, datë 25.07.2002, "Për Prefektin", shprehemi si më poshtë:

- 1.Vendimi i Këshillit të Bashkisë nr.35, datë 28.07.2016 "Mbi miratimin e emrit të z.Sokrat Mezin Driza për përfitimim e grantit të menjëhershëm për banesat me kosto të ulët", vlerësohet i ligjshëm.
- 2.Vendimi i Këshillit të Bashkisë nr.38, datë 28.07.2016 "Për shtyrjen e afatit të kontratës për administrimin dhe financimin e Shoqërisë Flamurtari Football Sh.A", miratohet si procedurë.
- 3.Vendimi i Këshillit të Bashkisë nr.39, datë 28.07.2016 "Për riorganizimin nëpërmjet bashkimit në një shoqëri të vetme, të Sh.A.Ujësjes Vlorë, Sh.A.Ujësjes Orikum dhe Sh.A.Ujësjesit Novoselë", miratohet si procedurë.
- 4.Vendimi i Këshillit të Bashkisë nr.40, datë 28.07.2016 "Për caktimin e anëtarëve të Këshillit Mbiqyres të Shoqërisë K.S Orikum Sh.A", miratohet si procedurë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE

Nr. 8340 Prot.

Vlorë, më 28 09, 2020

Lënda: Konfirmim të anëtarit të Këshillit Mbikqyrës

Shoqërisë "FLAMURTARI Football Club" SH.A
VLORE

Sikurse jeni në dijeni, me Vendimin nr.64 datë 14.08.2020 të Këshillit të Bashkisë Vlorë, është vendosur shtyrja e afatit me një vit të kontratës për administrimin dhe financimin e shoqërisë "FLAMURTARI Football Club", si dhe janë miratuar emrat e anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës.

Në këtë mbledhje, është miratuar që anëtari i Këshillit Mbikqyrës i propozuar nga Këshilli i Bashkisë të jetë z.Sokol Kushta, kurse anëtarët e propozuar nga shoqëritë "TRK GROUP" dhe "ATLAS Global" të jenë z.Sinan Idrizi, z.Kreshnik Cipi, z.Robert Islamaj. Kohëzgjatja e afatit të mandatit të anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës është 1 vit.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin

KRYETARI

Dritan Izeli
Dritan Izeli





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI

Nr. 52 / Ptot.

Vlorë, më 18.08.2020



VENDIM
Nr. 64, datë 14 / 08 / 2020

**“PËR SHTYRJE E AFATIT TË KONTRATËS PËR ADMINISTRIMIN DHE
FINANCIMIN E SHOQËRISË FLAMURTARI FOOTBALL CLUB SHA”**

Në bazë të nenit 8/2, 9/1.2, 25/4, 54 të ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", në ligjin Nr.79/2017, "Për sportin" neni 20, neni neni 33, neni 39 e vijim, ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" neni 135, neni 167, Statutit dhe Aktit të Themelimit të shoqërisë "Flamurtari Football Club", Rregullorja dhe Statuti i Federatës së Shqiptare të Futbollit, VKB nr.39 datë 31.07.2014 "Për disa ndryshime në administrimin e shoqërisë Flamurtari Football Club sh.a", VKB nr.38 datë 01.08.2016 "Për shtyrje të afatit të kontratës për administrimin dhe financimin e shoqërisë Flamurtari Football Club sh.a", VKB nr.89 datë 26.07.2018 "Për shtyrje të afatit të kontratës për administrimin dhe financimin e shoqërisë Flamurtari Football Club sh.a", "Marrëveshjes së financimit dhe administrimit të shoqërisë "Flamurtari Football Club" të lidhur midis Bashkisë Vlorë dhe shoqërive "TRK GROUP + ATLAS Global", Këshilli i Bashkisë Vlorë,

VENDOSI

1. Të miratohet shtyrja për një periudhë 1 vjecare e afatit të kontratës së financimit dhe administrimit të shoqërisë "Flamurtari Football Club" të lidhur midis Bashkisë Vlorë dhe shoqërive "TRK GROUP + ATLAS Global".
2. Të miratohen emrat e Anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës, si më poshtë vijon:
 - a) Sinan Idrizi
 - b) Kreshnik Cipi
 - c) Robert Islamaj
 - d) Propozim nga Këshilli i Bashkisë

Kohëzgjatja afatit të mandatit e anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës do të jetë një vit. Ata kanë të drejtë të rizgjidhen.

- 3 Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit Nr.139, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen Vendore".

KRYETAR
Migena Balla





**“FLAMURTARI” FOOTBALL CLUB
VLORE**

Adresa: Lagjja “Pavaresia”, Stadiumi Flamurtari, Vlore, Tel,Fax: 033 421242,fcflamurtarivlore@gmail.com

Vlorë, 26 . 05 .2021

QENDRËS KOMBËTARE TË BISNESIT

VLORE

VENDIM BORDI

Bordi Drejtues i Flamurtari Football Club i riemëruar me vendim nr.64, datë14.08.2020 të Këshillit të Bashkisë Vlorë, në mbledhjen e tij ditën e sotme më datë 26 . 05 . 2021, në praninë e të gjithë anëtarëve të Bordit z.Sinan Idrizi, z. Kreshnik Cipi, z.Robert Islamaj dhe përfaqësuesi i Këshillit të Bashkisë z.Sokol Kushta,

VENDOSI

- 1.Largimin nga detyra e Administratorit te z.Ardi Behari.
- 2.Zgjedhjen e z.Sinan Idrizi si Administrator të Flamurtari Football Club.

Anëtarë:

- 1.Sinan Idrizi
- 2.Kreshnik Cipi
- 3.Robert Islamaj
- 4.Sokol Kushta

